


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar




OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE, QARKU ELBASAN



Qarku i Elbasanit ka një popullsi prej 423,757 banorë¹. Ai përbëhet nga Rethi Elbasan, Gramsh, Peqin dhe Librazhd, me 51 Komuna dhe Bashki përkatësisht: 8 Bashki dhe 43 Komuna. Qyteti i Elbasanit është qyteti më i rëndësishëm në Qark, i cili është edhe qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Elbasan.

Historia e trevave të Elbasanit e ka zanafillën e saj në shekullin II p.e.s. me vendbanimet e hershme ilire. Nga të dhënat arkeologjike besohet se emri i parë i Elbasanit ka qenë *mansius* që do të thotë vend-qëndrim. Në shekullin II qyteti njihet me emrin Skampius e më vonë me emrin Skampi dhe ishte



1. Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bredhshme, Mars 2011



në varësinë administrative të Durrahut (Durrësit). Duke qenë i vendosur në kryqëzimin e rrugëve Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim, ai ka shërbyer si pikë e rëndësishme kalimi dhe si stacion i rëndësishëm, duke u përmendur si qendër urbane, ushtarake e peshkopale. Gjatë periudhës Romake Skampius njohu lulëzimin e tij më të madh sepse ishte një kryqëzim rrugësh ku perandoria romake ndërtoi rrugën *Via Egnatia*, një rrugë strategjike nga pikëpamja ushtarake dhe rëndësisë ekonomike. Rruga lidhte Romën me Kostandinopojën.


Para Luftës së Dytë Botërore, Elbasani ishte një qytet me një përzierje të ndërtesave lindore dhe mesjetare, rrugët e ngushta me kalldrëm dhe një pazar të madh. Në atë kohë popullsia ishte rreth 15,000 banorë.

Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Në Qarkun e Elbasanit, në vitin 2010, jetojnë 128,387 fëmijë (0-18 vjeç) ose 30% e popullsisë.


Qarku i Elbasanit në vitin 2010 ka 2.490 fëmijë¹ (1.9%) me aftësi të kufizuar. Rrethi i Gramshit dhe i Librazhdit kanë përqindjen më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuar, përkatësisht rrethi Gramsh 2.2% (247 fëmijë) dhe rrethi Librazhd 2% (487 fëmijë).

1 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Qershor 2011).



Numri i familjeve që trajtohen me Ndhmë Ekonomike (NE) dhe që kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç ka ardhur në rënie nga viti në vit. Në vitin 2010 numërohen 10,117 familje të varfra, 174 familje më pak se viti 2009 (10,291 familje) dhe 203 familje më pak se viti 2008 (10,320 familje).

Krahasimi ndërmjet viteve 2008, 2009 dhe 2010 tregon se numri i fëmijëve 6-15 vjeç që jetojnë në familje të varfra është i ndryshueshëm. Kështu, nga 11.583 fëmijë² në vitin 2008, numri ulet me 211 fëmijë në vitin 2009 duke shkuar në vlerën 11.362³ dhe në vitin 2010 numri rritet me 1.148 fëmijë në nivel Qarku. Raporti i fëmijëve të varfër nga viti 2009 në 2010 nuk ka ndryshuar. Si në vitin 2009, ashtu dhe në vitin 2010 në Qarkun e Elbasanit 1 në 6 fëmijë (ose 12.510 fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jetojnë në familje të cilat trajtohen me Ndhmë Ekonomike (NE).



2 Burimi: Zyra e Shërbeve Sociale (Qarku Elbasan)

3 Ibid;



Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihmë ekonomike dhe kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç në Qarkun e Elbasanit paraqitet e lartë në Komunat: Lenie (58.9%), Zavaline (29.7%), Polis (24.9%) dhe Prenjas (24.3%), -krahasuar kjo me Komunat e tjera të Qarkut.

	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor ¹		1089	1677	836
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar ²	31265	4691		5168
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm ³	9365	1387	2599	753

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Elbasanit në vitin 2009, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkëlqen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.

1. Burimi: Drejtoria Arsimore Rajonale, Elbasan; Tetor 2012

2. Ibid;

3. Ibid;

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Elbasan gjendet në:





Lagja: "Haxhias",

Rruga "Ramazan Sina", Ish Kinema Vullnetari

Elbasan, Shqipëri





e-mail: observatori_elbasan@yahoo.com

URL: www.observator.org.al



Politika Rajonale që ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Në Qarkun e Elbasanit është hartuar Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për të drejtat e fëmijëve. Njësia për të Drejtat e Fëmijëve pranë Këshillit të Qarkut, e mbështetur nga Këshilli i Qarkut dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile, po harton strategjinë e re për fëmijë 2011-2015. Hartimi i strategjisë rajonale ka filluar në Nëntor të vitit 2011 dhe është në përfundim e sipër.



Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Elbasan, veç zyrës së Observatorit është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve në Qark.

Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë", - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.

